VENDIM
Nr.69, datë 14.11.2005

PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË KURUM ENERGY SHA, PËR KLIENTIN E KUALIFIKUAR KURUM INTERNATIONAL SHPK

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, germa ç dhe nenit 45 pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.27, datë 30.5.2004 "Rregullorja për procedurat e licencimit", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.11.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria Kurum Energy sh.a., për marrjen e licencës së furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Dhënien e licencës së furnizuesit të kualifikuar, me afat 1 vit, shoqërisë Kurum Energy sh.a., për furnizimin e klientit të kualifikuar "Kurum International" sh.p.k., e cila mbështet financiarisht shoqërinë Kurum Energy sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema